



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 1016/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Kymete Kicaj dhe Adnan Konushevci, anëtarë, duke vendosur përkritazi me apelin e Mexhide Hoxha, kandidate për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prishtinës nga subjekti politik Aleanca Kosova e Re (AKR) dega Prishtinë, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur me datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET i pabazuar apeli Anr.1016/2021 i datës 04.11.2021 i parashtruar nga kandidatja për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prishtinës Mexhide Hoxha nga radhët e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR) dega Prishtinë, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 nga kandidatja për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prishtinës Mexhide Hoxha nga radhët e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR) dega Prishtinë, në të cilën konstaton se ka shkelje të ligjit konkretisht neni 26 për zgjedhjet lokale nr. 03/L-072 dhe neni 101 i ligjit 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së apelit dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli, vlerëson se parashtruesja e apelit nuk ka specifikuar ndonjë parregullsi, por vetëm se thekson se ka pasur shkelje të nenit 26 të ligjit për zgjedhjet lokale nr. 03/L-072 dhe neni 101 i ligjit 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme, dhe ka bashkangjitur disa fotografi me emra të kandidatëve, por se nga këto emra shihet vetëm emri dhe mbiemri i saj por jo edhe numri i votave edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur ndonjë parregullsi eventuale, për faktin se thëniet e saj për shkelje të ligjit janë vetëm supozime dhe të pa konkretizuara në ndonjë parregullsi.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar nga Mexhide Hoxha nga radhët e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR) dega Prishtinë, nuk është i bazuar me asnjë provë apo dëshmi konkrete ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, andaj u vendos si në dispozitiv.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.1016/2021 më datën 07.11.2021



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.